

11. Programi për Hulumtime dhe Publikime

Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP) synon që gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe profesionistëve tjerë ligjor t'i ofrojë mbështetje praktike dhe teknike për hulumtim si dhe qasje në burime të ndryshme ligjore me të cilat disponon Biblioteka Ligjore e Akademisë së Drejtësisë. Gjithashtu përmes këtij programi do të mundësohet gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe përfituesve tjerë sipas ligjit në realizimin e punimeve hulumtuese dhe publikimin e rezultateve në revistat e Akademisë së Drejtësisë.

Fokusi i Programit për Hulumtime dhe Publikime do të jetë në krijimin dhe konsolidimin trupave profesionale për vlerësim si dhe standardeve për publikime të cilat sigurojnë cilësi për publikimet e Akademisë me theks të veçantë te revistat “Justicia” dhe “Opinio Juris”, modulet trajnuese, doracakët dhe format tjera të publikimeve.

Përveç aspektit të hulumtimeve dhe publikimeve programi do të orientohet edhe në zhvillimin e programeve trajnuese përmes procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe hulumtimeve tjera të cilat i kontribuojnë cilësisë së programeve dhe metodologjisë trajnuese. Në kuadrin e Bibliotekës ligjore do të fokusohet në begatimin dhe pasurimin e vazhdueshëm me libra dhe burime ligjore vendore dhe ndërkombëtare në forme fizike apo elektronike, abonimin në data baza ndërkombëtare si dhe në inkurajimin e përfituesve të saj sipas ligjit në shfrytëzimin e resurseve që ofron biblioteka si për zbatimin e trajnimeve ashtu edhe për procesin e punës në gjykata dhe prokurori.

Programi gjithashtu do të mbështesë iniciativat e ndryshme në nivel nacional që kanë të bëjnë me ngritjen e cilësisë në sistemin e drejtësisë në vend.